



Planuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	23	12	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br Prot Prot No	Shojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKIMSHUK	8401	2022	113		



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1006/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1006/2022 të datës 14.11.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] nga [redacted] me adresë banim në [redacted] në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1006/2022 e datës 14.11.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Komunën e Klinës, më datë 14.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7060/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar me datë 22.11. dhe 23.11.2022, me pretendimin ankimor për njohje të së drejtës lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë (7) në nëntë(9).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 15.11.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit më datë 22.11.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokollit 7060/2022 të datës 14.11.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës me numër të protokollit 7340/2022 të datës 23.11.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër 02Nr.112-4390/14 të datës 01.09.2014; Kontratën Themelore të Punës me numër 02Nr.112-4542/09 të datës 01.11.2009; Aktin e emërimit me numër 02Nr.112-282/16 të datës 01.01.2015; Vendimin për Themelimin e marrëdhënies së punës pa afat me numër 01Nr.112-3873/2010 të datës 23.09.2010; Vendimin për Rritjen e Koeficienteve të shërbyesve civil të administratës komunale të Klinës me numër 01Nr.112-2224/2012 të datës 08.05.2012; Njoftimin nga Komuniteti për Politikë dhe Financa lidhur më kërkesën e ankueses me numër 01Nr.12-1694/10 të datës 23.06.2010; Kontratën e punës me numër 02Nr.112-1407/03 të datës 24.04.2003; Aktvendimin me numër 04Nr.112-21/02 të datës 29.01.2002 mbi caktimin e punëtorit në vendin e punës; Vendimin me numër 04Nr.86/2001 të datës 25.09.2001; E-mailin e datës 22.11.2022 të dërguar nga R.D drejtuar I.M; E-mailin e datës 22.11.2022 të R.D drejtuar I.M.; Listën e pagës për periudhën kohore 01.10.2022 deri 31.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë në numër të protokollit 7122/2022 e datës 15.11.2022; Përgjigja në ankesë me numër të protokollit 7246/2022 e datës 21.11.2022; E-mailin e datës 05.10.2022 të dërguar nga R.D drejtuar Xh.D ; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtare e Shpenzimeve"; Njoftimin me numër 05Nr.120-39435/2022 të datës 18.11.2022 lidhur me ngritjen e Koeficienteve për Zyrtarët Publik të Komunës së Klinës; E-mailin zyrtar të dërguar nga L.Z drejtuar KPMSHCK-së me numër të protokollit 7472/2022 të datës 29.11.2022; emailin) e datës 29.11.2022 me numër protokollit 7472/2022 dhe emalin e datës 20.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankueses, *sepse*:

Nga administrimit i provave materiale rezulton se ankuesja është e punësuar në Komunën e Klinës, gjegjësisht e njëjta ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Shpenzimeve*, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa me koeficient gjashtë (6) të pagës. Kryetari i Komunës përmes Vendimit me numër 01Nr.112-2224/2012 të datës 08.05.2012 kishte bërë rritjen e koeficienteve të shërbyesve civil të administratës në komunalnë Komunën e Klinës, më ç' rast ankueses i është bërë rritja e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në shtatë (7).

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesja më datë 07.09.2022 ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit për ngritje të koeficientit të pagës pa specifikuar koeficient, ndërsa përmes Njoftimit me numër 05Nr.120-39435/2022 të datës 18.11.2022 të Drejtorit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim në Komunë e Klinës drejtuar Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore citohet se: " *për ngritjen e koeficienteve për zyrtarët publikë duhet të keni për bazë Planifikimin Buxhetor nga se zyrtarët të cilët nuk janë planifikuar në buxhet nuk mund të ju rritet koeficienti sepse haset në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin të miratuar*".

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti bëhet harmonizimi i koeficientit sikurse kolegeve të saj ku disa kanë koeficient shtatë pikë pesë (7.5) ndërsa disa kanë koeficient nëntë (9). Duke shtuar së ankesën e mbështetet mbi bazën se e njëjta ka përgatitjen profesionale, vlerësimin nga kryetarët për punën e kryer me përgjegjësi të plotë dhe nderë, e po ashtu edhe për shkak të rritjes së vëllimit të punës.



Lidhur me pretendimin e ankuesit për harmonizim të koeficientit të pagës, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", si dhe nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë më të cilin parashihet se: "Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë". Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesja është emëruar dhe e njëjta ushtron pozitën e punës Zyrtare për Shpenzime me koeficient shtatë (7) të pagës si dhe duke u bazuar në shkresën (emailin) e datës 29.11.2022 me numër protokollit 7472/2022 dhe emalin e datës 20.12.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë, me të cilin është konfirmuar se pozita Zyrtar për Shpenzime është e përcaktuar në kategorinë profesionale nga detyrat dhe përgjegjësitë tek klasa profesional 2 dhe 3, me koeficient shtatë (7) të pagës tek klasa profesional 2 dhe koeficient gjashtë (6) të klasa profesional 3, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit për harmonizimin të koeficientit të pagës nga shtatë (7) në nëntë (9) nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, rrjedhimisht nuk ka mbështetje në aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet çështja e pagave të zyrtarëve publikë, ashtu sikurse nuk ka mbështetje as në politikat e nënshkruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, si organ përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës, dhe në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se nuk ka ndonjë lloj diskriminimi në raport me ankuesen.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1006/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së